



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 393/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV) dega në Fushë Kosovë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Fushë Kosovë, për shkak të vendosjes së posterave në objektet publike, në seancën e panelit të mbajtur me 01.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosja (LVV) dega në Fushe Kosove

Arsyetim

PZAP-i, më datë 30.10.2013 ka pranuar një ankesë, nga subjekti politik LVV dega në Fushe Kosove, në të cilën theksohet se me datën 29 tetor 2013, në ora 13:00 aktivistet e levizjes Vetevendosjes në Fushe Kosove kanë vërejtur posterin e PDK-se që ishte ngjitur në strukturën publike në Rr.Nene Tereza, konkretisht në strukturën e stacionit lokal të trafikut urban. Duke qene se struktura në fjalë është në pronësi publike të komunes ngjitja e materialit zgjedhore është në kundërshtim me dispozitat ligjore që janë në fuqi. Posteret e ngjitur janë të kandidatit për anetar të kuvendit komunal, Bajram Shala. Me këtë rast parashtruesi i ankesës konsideron se këto veprime janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi fotot nga vendi i supozuar i ngjarjes.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe nga pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se anëtarët e subjekti politik PDK-se kanë bërë vendosjen e posterave në objektet publike PZAP-i i vlerëson si pabazuar dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, pasi që nga fotot e ofruara si dëshmi nuk mund të vërtetohet se posterat në fjalë janë të vendosura në objekt publik ashtu siç pretendon pala ankuese në ankesën e saj, andaj ankesa e tillë është e pabazuar dhe se për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 393/2013 më datën 01.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muharrëm Shala**



Këshillë Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore*